

VENDIM
Nr.130, datë 2.12.2008

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GEN-I TIRANA” SHPK PËR KRYERJEN E
AKTIVITETIT TË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, pika 1 germa “d”, 13 dhe 14, të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.12.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gen-I Tirana” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të “Gen-I Tirana” sh.p.k., ka nisur me marrjen e vendimit nr.111, datë 16.9.2008.

2. Dokumentacioni për aplikimin për licencimin për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike është paraqitur i plotë sipas rregullores për procedurat e licencimit, të miratuar me vendimin nr.21, datë 4.4.2007.

3. Shqyrtimi i këtij aplikimi bëhet sipas rregullores për procedurat e licencimit, të miratuar me vendimin nr.21, datë 4.4.2007, mbasi në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, e cila, në nenin 20, përcakton se për të gjitha aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të aplikohen rregullat e përcaktuara në rregulloren e procedurave të licencimit të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Gen-I Tirana” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike me një kohëzgjatje të vlefshmërisë së licencës prej 5 vjetësh.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta